Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

20. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

21. Konvertimi në valutë të vetme

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata

kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
 - b) garanci bankare;
 - c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës** 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me

ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin perfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Hyrje

Ky projekt synon të krijojë një eksperiencë multimediale interaktive, e cila prezanton në mënyrë inovative dhe edukuese Mozaikun e Tiranës dhe/ose mozaikë të tjerë të trashëgimisë kulturore shqiptare. Instalacionet do të kombinojnë teknologjinë digjitale me përmbajtje historike, artistike dhe arkivore, duke e bërë të qasshme për publikun e gjerë historinë dhe vlerat kulturore të këtij arti monumental.

Qëllimi përfundimtar është rritja e ndërveprimit dhe përfshirjes së vizitorëve në hapësirat muzeale dhe kulturore, përmes teknologjive të reja të komunikimit dhe interpretimit.

1	Instalim Digjital ne pjesen e jashtme te Godines - PERISKOPË DIGJITAL Zbuloni Mozaikun e Plotë	
	Fotografimi dhe Rikonstruksioni Digjital i Mozaikut. Prodhimi dhe trajtimi grafik i permbajtjes Multimediale Vizuale te paraqitjes se Mozaikut. Dizenjimi i Nderfaqes dhe Zhvillimi i Aplikacionit per pajisjet AR/VR. Integrimi i pajisjeve digjitale Tableta / AR / VR ne strukture metalike.	1
	Struktura metalike / inox per perdorim te jashtem ku integrohen Tableta ose VR. Por t'u propozuar nga ofertuesi.	2
	Pajisjet per Konsumimin e Permbajtjes Tableta ose VR. Per t'u specifikuar ne baze te zgjidhjes interaktive qe do te propozojte ofertuesi.	2

Ky projekt ka për qëllim rikrijimin dhe paraqitjen interaktive të Mozaikut të Tiranës, përmes një instalacioni multimedial të dedikuar. Mozaiku, i cili aktualisht paraqitet i dëmtuar, do të rikrijohet digjitalisht duke plotësuar pjesët e munguar në mënyrë vizuale dhe artistike. Mbushja e pjesëve të munguara duhet të realizohet duke përdorur elementet ekzistues. Rikrijimi duhet të shihet në hapësirën e muzeut përmes ekraneve tabletë ose syze virtual reality. Vizitori duhet të jete në gjendje të shohi se si dukej mozaiku.

Përshkrimi i Punës dhe Kërkesave Teknike:

1. Fotografimi dhe Rikonstruksioni Digjital i Mozaikut

- Realizimi i fotografimit me rezolucion minimal **24 Mega Pixel** ose ekuivalent, duke përdorur metoda profesionale
- Përdorimi i pajisjeve profesionale për të siguruar uniformitet dhe shmangien e deformimeve. Rikonstruksion digjital i mozaikut, duke përdorur elementet ekzistuese për të plotësuar pjesët e dëmtuara/munguara.
- Trajtimi i imazheve, përfshirë korrigjim ngjyrash, balancim kontrasti dhe harmonizim vizual, për të garantuar cilësi maksimale.
- Dorëzimi i materialeve në formate standarde **TIFF/PNG (imazhe)** dhe **OBJ/FBX (modele 3D)**.

2. Prodhimi i Përmbajtjes Multimediale Vizuale

- Krijimi i animacioneve, grafikave dhe elementeve vizuale që shpjegojnë historinë, stilin dhe rëndësinë e mozaikut.
- Përpunimi i materialeve multimediale (video, audio, tekst, materiale arkivore).
- Përshtatja e përmbajtjes për shfaqje interaktive në formate AR/VR dhe / ose tableta.

3. Dizenjimi i Nderfaqes dhe Zhvillimi i Aplikacionit:

- Zhvillimi i një aplikacioni interaktiv multimedial që funksionon në pajisje digjitale. Ne fazen e parë të zbatimit të kontratës, Kontraktori duhet të propozojë zgjidhje teknologjike në zhvillimin e aplikacionit sipas kriterëve:
 - Prodhimi i aplikacionit për tu përdorur në Tableta, Pajisje VR (Virtual Reality) apo Pajisje AR (Augmented Reality)
 - Ndërfaqja duhet të jetë ****miqësore për përdoruesin****, me navigim intuitiv dhe dizajn bashkëkohor.
 - Përmbajtja e aplikacionit të jetë të paktën dygjuhëshe (Shqip dhe Anglisht).
 - Informacione duhet të jenë të strukturuar saktë sipas temave (historike, artistike, teknike).

4. Integrimi i Pajisjeve Digjitale në Strukturë Metalike:

Ne fazen e parë të zbatimit të kontratës, Kontraktori duhet të propozojë prodhimin ose furnizim

me struktura te posacme metalike per vendosjen e pajisjeve digjitale per konsumimin e permbajtjes digjitale.

- Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve digjitale ne varesi te zgjidhjes multimediale qe do te ofrohet;
- Tableta të dedikuara për përmbajtjen multimediale ose pajisje VR/AR të përshtatshme për përdoruesit.
- Integrimi i këtyre pajisjeve në një strukturë metalike të personalizuar, ergonomike dhe të sigurt për përdorim publik e kushte te jashtme atmosferike.
- Sigurimi i kabllimit, ushqimit me energji dhe sigurisë fizike të pajisjeve.
- Opsionale, sistem mbikëqyrës për mirëmbajtje dhe përditësim të përmbajtjes.

5. Dorëzimet:

- Fotografitë e mozaikut në format RAW dhe të përpunuar.
- Modeli 3D dhe materialet multimediale të përgatitura për integrim.
- Aplikacioni interaktiv funksional.
- Pajisje digjitale, Tableta ose VR sipas zgjidhjes interaktive te se propozuar.
- Strukturë metalike e integruar me pajisjet digjitale të instaluar dhe testuara.
- Manual përdorimi dhe mirëmbajtjeje.

Specifikimet Teknike te Pajisjeve ne varesi te zgjidhjes interaktive te propozuar:

Tableta:

Specifikime Teknike Minimale – Tabletë Rugged 8"

- Madhësia Ekranit: 8 inch.
- Rezolucioni: minimum 1920×1200 (Full HD).
- Ndriçimi (Brightness): ≥ 1000 nits (përdorim i plotë në dritë dielli).
- Prekje: multi-touch, i përdorshëm edhe me doreza ose në kushte me lagështi.
- CPU: minimum Octa-Core 2.0 GHz ose qekuivalent
- GPU: e dedikuar ose e fuqishme për aplikacione grafike.
- RAM: ≥ 8 GB.
- Storage / Memorie e brendshëm: ≥ 128 GB.
- Slot SD / zgjerim: opsional.
- Sistemi Operativ OS: Android 10 ose më i lartë.
- Kamera: Front Camera: ≥ 6 MP.
- Rear Camera: ≥ 12 MP.
- Bateria: Kapaciteti: ≥ 10.000 mAh.
- Kohë pune: ≥ 10 orë përdorim aktiv.
- Karikim: USB-C, me mbështetje fast charge $\geq 30W$.
- Lidhjet Wi-Fi: 802.11 a/b/g/n/ac.
- Bluetooth: 5.0 ose më i lartë.
- GPS: i integruar me mbështetje për GPS / GLONASS / Galileo.
- SIM (4G LTE / 5G opsional): minimum 4G LTE.
- Porta: USB-C me OTG.
- Konstrukti & Rezistenca
- Rezistencë ndaj ujit/pluhuri: minimum IP52.
- Rezistencë ndaj goditjeve: MIL-STD-810H (rënie deri në 1.5 m).
- Përdorim i jashtëm: rezistencë ndaj temperaturave ekstreme -20°C deri $+60^{\circ}\text{C}$.

Të tjera:

- Audio: altoparlant + mikrofon i integruar.
- Aksesorë: karikues + kabllo përfshirë.
- Certifikime: CE, RoHS, FCC.

Pajisje VR:

- Ekranit & Optika:
- Rezolucioni i ekranit: minimum 4K (3840×2160) total ($\geq 1920 \times 2160$ për sy).

- Tipi i panelit: Fast-Switch LCD / OLED.
- Refresh Rate: ≥ 75 Hz (opsional ≥ 90 Hz).
- FOV (Field of View): $\geq 100^\circ$.
- Interpupillary Distance (IPD): i rregullueshëm manualisht ose automatikisht.
- Procesori & Performanca, CPU: Qualcomm Snapdragon XR2 ose ekuivalent.
- RAM: ≥ 6 GB.
- Storage i brendshëm: ≥ 128 GB.
- Slot SD / zgjerim: opsional.
- Sistemi & Software OS: Android bazuar për VR (SDK të hapura për zhvilluesit).
- Përputhshmëri: mbështetje për Unity & Unreal Engine.
- Menaxhim i përmbajtjes: platformë dedikuar / kiosk mode për muze & instalacione.
- Tracking & Kontrollor, Tracking: 6DoF (head & hand).
- Kontrollorë: 2x kontrollorë VR me gjurmim të plotë, sensorë IMU dhe butona standardë.
- Tracking pa bazë të jashtme: inside-out tracking me kamera të integruara.
- Audio & Komunikimi: altoparlantë stereo të integruar + jack 3.5mm.
- Mikrofon: i integruar me anulim zhurme.
- Wi-Fi: Wi-Fi 5 (802.11ac) ose më i lartë.
- Bluetooth: 5.0 ose më i lartë.
- Opsion lidhjeje me PC: USB-C.
- Bateria. Kapaciteti baterisë: ≥ 5000 mAh.
- Kohë përdorimi: ≥ 2.5 orë në përdorim aktiv.
- Karikim: USB-C fast charge.
- Konstrukti & Ergonomia
- Pesha totale: ≤ 700 g.
- Përshtatshmëri: rripa të rregullueshëm, e balancuar për përdorim të gjatë.
- Rezistencë: për përdorim intensiv publik (muze, evente).
- Certifikime: CE, RoHS, FCC.

2 Instalacion Interaktiv - ZBULONI MOZAIKËT E SHQIPËRISË	
Instalacion me Eksperience Interaktive ne hapesire nepermjet nje ekrani ku evidentohen materiale per mozaikun e Tiranës apo mozaikë të tjere të Shqipërisë. Prodhimi i Permbajtjes Multimediale me materiale digjitale, grafike, video, fotografike apo arkivale. Programimi dhe Implementimi instalacionit multimedial interaktiv. Nderfaqja Interaktive duhe te jete te pakten ne dy gjuhe në Shqip dhe Anglisht.	
Ekran Panel Led Mural Flex i cilesise se larte ne rezolucion te pakten P2, ne permasa deri ne 320 cm x 360 cm perfshire pajisjet hardware te kontrollit te figures dhe lidhjeve video.	1
Sistem integruar workstation me karte grafike te dedikuar dhe i afte per kalkulime dhe procese komplekse grafike dhe vizuale: Specifikime minimale: Desktop / Rackmount (preferohet) Workstation, CPU Intel Core i7/i9 (14th gen), RAM 64Gb, GPU Nvidia RTX 4080, SSD Nvme M2 512gb Sistem, 2TB Data.(Redundant PSU preferohet). Monitor 24", Tastiere, mouse wireless. Sistem Operativ Windows 11 Pro.	1
Kamera digjitale dhe sensor thellesie.	1
Sistem Audio Stereo i vete-amplifikuar (active), 2.1. 1000 Wat.	1
Paisje Ups per workstation. 1500VA, 900W.	1

Qëllimi i këtij instalacion multimedial e interaktiv, prezanton në mënyrë inovative materialet për Mozaikun e Tiranës dhe/ose mozaikë të tjerë të Shqipërisë. Instalacioni do të shërbejë si një eksperiencë edukuese dhe përfshirëse për vizitorët, duke kombinuar teknologjinë digjitale me përmbajtje historike, artistike dhe arkivore.

Përshkrimi i Punës dhe Kërkesave Teknike:

2.1. Pajisjet dhe Infrastruktura Teknike

- Panel Led me rezolucion të lartë, i përshtatshëm për përdorim në hapësira të mbyllura dhe rezistent ndaj konsumimit të vazhdueshëm.
- Ekranin duhet të vendoset në hapësirën e posaçme të përgatitur enkas sipas përmasave me lart.
- Sistem kompjuterik (media server) me kapacitete të mjaftueshme për përpunim grafik dhe video në kohë reale.
- Kamera digjitale me sensor thellesie.
- Sistem audio për shoqërim multimedial (altoparlantë mi sistem të amplifikuar të integruar ose të jashtëm).
- Strukturë mbajtëse / kioskë e dizenuar për hapësirën ku do të vendoset instalacioni në hapësirën e përcaktuar.

2.2. Përmbajtja Multimediale dhe krijimi si dhe përpunimi i saj duhet të bazohet në:

- Materiale digjitale dhe grafike mbi mozaikët: fotografi me rezolucion të lartë, skanime, elementë grafikë të ripunuar.
- Materiale arkivore të digjitalizuara dhe të përshtatura për prezantim publik.
- Video prezantuese (animacione, dokumentarë të shkurtër ose montazhe artistike).
- Narracion / tekst shpjegues për vizitorët.

2.3. Integrim dhe Zhvillim Aplikacioni.

Në fazën e parë të zbatimit të kontratës, Kontraktori duhet të propozojë një zgjidhje inteligjente softuearike që parashikon interaktivitetin e vizitorit me sistemin e integruar për konsumuar përmbajtjen multimediale të prodhuar. Për këtë është i nevojshëm:

- Zhvillimi i një aplikacioni interaktiv për ekranin, i cili mundëson navigim intuitiv të përmbajtjes.
- Funksionalitete kryesore:
 - Prekje dhe ndërveprim (touch gestures).
 - Shfaqje dinamike e fotografive, videove dhe teksteve.
 - Zoom-in/zoom-out për detaje të mozaikëve.
 - Organizim sipas kategorive (p.sh., “Mozaiku i Tiranës”, “Mozaikë të Shqipërisë”, “Historia dhe konteksti kulturor”).
 - Nderfaqja e përdoruesit (UI/UX): dizajn i qartë, miqësor për publikun e gjerë, me fokus tek përvoja vizuale dhe ndërvepruese.
 - Gjuhët: minimumi dy gjuhë – Shqip dhe Anglisht.

4. Dorëzimet.

- Koncepti dhe storyboard i përmbajtjes multimediale, duke përfshirë strukturimin e narrativës historike, artistike dhe kontekstuale të mozaikut.
- Zhvillimi dhe dorëzimi i aplikacionit interaktiv.
- Instalimi i plotë i pajisjeve dhe konfigurimi i software-it.
- Testimi final dhe dorëzimi gati për përdorim.
- Manual përdorimi, trainime dhe udhëzime për mirëmbajtje.

Specifikimet Teknike të Pajisjeve në varesi të zgjidhjes interaktive të propozuar:

Ekran Panel Led Mural Flex Specifikime Teknike Minimale – Panel LED Fleksibël

- Parametrat Optikë
 - Pitch i pikselit: $\leq P1.5$ mm (ose më i dendur, p.sh. $P1.2 / P1.25$).
 - Tipi i LED-it: SMD (preferohet Black SMD për kontrast më të lartë).
 - Shkëlqimi (Brightness): $\geq 800 - 1000$ nits (përdorim i brendshëm).
 - Raporti i Kontrastit: $\geq 4000:1$.
 - Këndi i shikimit: $\geq 160^\circ$ horizontal / $\geq 140^\circ$ vertikal.
 - Freskimi (Refresh Rate): ≥ 1920 Hz (ideal ≥ 3840 Hz për kamera / filmim).
- Paneli

- Dimensionet e modulit LED: rreth 240×120 mm ose ekuivalent, fleksibël.
- Trashësia e panelit: ≤ 15 mm (ultra-slim, fleksibël).
- Pesha e panelit: ≤ 0.5 kg për modul (për lehtësi montimi).
- Madhësia e kabineteve fleksibël: tipikisht 480×320 mm ose ekuivalent.
- Struktura e montimit: magnetike + sistem fiksimi për kornizë fleksibël.
- Opsion i montimit: konveks, konkav, formë cilindrike, valë, etj.
- Jetëgjatësia LED: ≥ 100.000 orë.
- Shkalla e riprodhimit të ngjyrave (Color Gamut): ≥ 90% NTSC / Rec.709.
- Uniformiteti i ndriçimit: ≥ 95%.
- Elektronika dhe Kontrolli
 - Driver IC: me teknologji PWM / Common Cathode për konsum më të ulët energjie.
 - Sistemi i kontrollit: Asynchronous / Synchronous Controller (Novastar / Colorlight / Brompton preferohen për cilësi të lartë) ose ekuivalente.
 - Lidhja e të dhënave: Ethernet, HDMI, DVI, SDI, opsional 4K input.
 - Redundancë: Opsion për redundancë të dyfishtë të energjisë dhe sinjalit.
 - Konsumi maksimal i energjisë: ≤ 600 W/m².
 - Konsumi mesatar: ≤ 200–250 W/m².
 - Fuqia hyrëse: 100–240V AC, 50/60Hz.
 - Klasa e mbrojtjes: të paktën IP30 (brenda).
 - Temperatura e punës: -10°C deri +45°C.
 - Lagështia relative: 10% – 85% (pa kondensim).
- Karakteristika të tjera
 - Preferohet Montim / çmontim i shpejtë: instalim pa vidha, lidhje magnetike ose me kornizë fleksibël.
 - Kontroll i ngjyrave / kalibrim: software për kalibrim automatik ose manual.

Kompiuter Workstation:

- Specifikime minimale Workstation form-factor Desktop / Rackmount (preferohet)
- CPU Intel Core i7/i9 (14th gen e siper), Alternativisht Intel Xeon W ose AMD Ryzen 9 / Threadripper.
- Berthama: ≥ 10 core / 20 threads, Frekuenca: 3.0 Ghz
- Minimum 64 GB DDR4/DDR5 ECC ose jo-ECC, me mundësi zgjerimi.
- Minimum RTX 4080 / NVIDIA RTX A4000 ose ekuivalent profesional
- VRAM ≥ 16 GB
- Duhet të mbështesë DirectX 12, OpenGL 4.6, Vulkan dhe CUDA / OptiX për përpunim grafik.
- SSD Nvme M2 512gb Sistem,
- SSD 2TB Data.
- Minimum Dual 1GbE Ethernet, preferohet edhe 10GbE opsional.
- Porta të shumta USB 3.0/3.2 / USB-C
- Minimum 2x DisplayPort / HDMI 2.1
- Mbështetje për shtim karta profesionale I/O
- Redundant PSU (preferohet). 750 - 1200 Watt Platinum.
- Monitor 24",
- Tastiere,
- Mouse wireless
- Sistem Operativ Windows 11 Pro.

Kamera digjitale dhe sensor thellesie.

- Specifikime Minimale Kamera Thellësie (Depth Sensor)
- Teknologjia e sensorit të thellësisë: Time-of-Flight (ToF) ose Structured Light
- Distanca operative: min. 0.25 m deri 3.5 m (short-range), deri 5 m (long-range)
- Rezolucioni i thellësisë (Depth Resolution) Minimum 640 × 576 px, Preferueshëm opsione deri në 1024 × 1024 px
- Fusha e shikimit (Field of View – FoV) Horizontal: min. 70° dhe Vertikal: min. 60°
- Shpejtësia e rifreskimit (Frame Rate), Min. 15 fps në rezolucion të plotë, Preferueshëm deri në 30 fps

- Kamera ngjyrash (RGB Camera), Rezolucion minimal 1920 × 1080 px (Full HD), Preferueshëm deri në 4K (3840 × 2160 px) Frame rate: 30 fps
- IMU (Inertial Measurement Unit), Përfshirë, me akselerometër + gyroskop për ndjekje të saktë të lëvizjes
- USB 3.0 ose më e lartë
- Audio (opsionale, por e dobishme për interaktivitet)
- Array me min. 4 mikrofona për kapje hapësinore të zërit
- Kompakt, me opsione montimi në tripod ose struktura metalike

Sistem Audio Stereo i vete-amplifikuar (active), 2.1.

- Specifikime Minimale – Sistem Audio 2.1 Aktiv (1000 W RMS Total)
- Konfigurimi, 2 satelitë aktivë (full range / mid-high) dhe 1 subwoofer aktiv (bass reflex)
- Ose Konfigurimi, 2 satelitë aktivë (full range / mid-high) dhe 2 subwoofer aktiv.
- Amplifikim i integruar (self-powered)
- Fuqia e daljes (Output Power) Totale min. 1000 W RMS
- Përgjigja frekuencore (Frequency Response)
- Satelitë: 70 Hz – 18 kHz
- Subwoofer: 35 Hz – 150 Hz
- Input / Output
- Min. 2 hyrje audio (XLR / TRS balanced) / RCA alternative.
- Kontrollët bazë: volum master + ndarje frekuencash (crossover)
- Crossover i integruar
- Frekuenca ndarëse: 80–120 Hz (rregullueshme)
- Mbrojtje nga mbinxehja dhe mbingarkesa
- Satelitë me mundësi montimi në tripod / strukturë
- Subwoofer me kasë të fortë (wooden enclosure, bass reflex)
- Tension pune: 220–240V AC
- Për përdorim të vazhdueshëm në hapësira publike / muzeale / evente interaktive

Paisje Ups per workstation.

- Specifikime Minimale – UPS 1500VA / 900W
- Kapaciteti, Fuqi: 1500 VA / 900 W
- Tension hyrës/ dalës: 230V AC
- Frekuenca: 50/60 Hz auto-sensing
- Autonomia (Tipike) Rreth 10–15 minuta @ 50% ngarkesë (~450 W), Rreth 2–5 minuta @ 100% ngarkesë (900 W)
- Koha e transferimit Tipike: 8 ms Maksimum: 12 ms
- Koha e karikimit: ~8 orë deri 100%
- Ndërfaqe & Menaxhim, LCD display për status (load, runtime, tension, etj.)
- Port USB për komunikim dhe shutdown software
- Daljet (Outlets), Totali: 8 dalje
- 6 me Battery Backup + Surge Protection
- 2 vetëm me Surge Protection
- Lloji: IEC C13 ose Schuko (në varësi të modelit)
- Mbrojtje kundër: mbingarkesës, mbinxehjes, qarkut të shkurtër, over/under-voltage

3 Instalacion Interaktiv - PANELE EKRANE Multi-Touch / Single Touch	
Rikonstruksioni 3D i Viles Romane, Prodhimi i Permbajtjes Multimediale, Zhvillimi i Aplikacionit dhe Implementimi. Nderfaqja Interaktive duhe te jete te pakten ne dy gjuhe në Shqip dhe Anglisht.	1
Strukture mobilje metalike hekur ose inoks, e gatshme ose e prodhuar posacerisht me ventilim/ajorosje. (125cm x 75cm x 20cm)	1
Pajisje digjitale, Tablete multi touch / single touch me prekje ne permase te pakten 50". Rezolucion 4K. 10 pika prekje ose me shume.	1
Kompjuter specifikime minimale: Small Form Factor / Mini Pc. CPU Intel Core i7 (14th gen),	1

RAM 64Gb, GPU Nvidia RTX 4060, SSD Nvme M2 512gb Sistem, 2TB Data. Tastiere, mouse wireless. Sistem Operativ Windows 11 Pro.	
Pajisje Ups per kompjuter. 1000VA, 600W.	1

Ky projekt synon rikonstruksionin 3D të Vilës Romane, prodhimin e përmbajtjes multimediale për interpretim kulturor dhe turistik, si dhe zhvillimin dhe implementimin e një aplikacioni interaktiv. Vila Romane do të rikrijohet virtualisht dhe përmbajtja multimediale do të bëhet e aksesueshme për publikun përmes një aplikacioni interaktiv shumëgjuhësh.

Përshkrimi i Punës dhe Kërkesave Teknike:

1. Rikonstruksioni 3D i saktë dhe me detaje i Vilës Romane.

- Skanime dhe matje në terren për të ndërtuar planvendosjen. (ky proces duhet të bëhet nën mbikqyrjen e IKTK)
- Modelim 3D me nivel të lartë detajimi, bazuar në dokumentacionin arkeologjik dhe arkitektonik.
- Rikrijim i elementëve origjinalë (mure, dysHEME, dekorime, mobilim) bazuar në burimet shkencore dhe ikonografike.
- Renderizime dhe animacione 3D të gatshme për përdorime të ndryshe në video, foto, apo aplikacion nese do te jene te nevojshme.

2. Prodhimi i Përmbajtjes Multimediale

